



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202000308/4

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandohet respektimi i procedurës për dhënien e masës disiplinore ndaj punonjësit të policisë së burgjeve (rasti i ish punonjësit E. D.) për sa i përket komunikimit të vendimit dhe saktësisë së mbajtjes së dokumentacionit*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE
Tiranë

IEVP PEQIN

Të nderuar,

Në letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur me institucionin tuaj jeni njohur me ankesën e shtetasit E. D., ish punonjës i policisë së burgjeve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin, i cili pretendon se nuk është informuar për arsyen e largimit nga puna në muajin korrik të vitit 2018 dhe nuk është njohur me vendimin që është marrë ndaj tij.

Për verifikimin e kësaj ankese nga ana jonë është administruar dokumentacioni që ka lidhje me dhënien e masës disiplinore ndaj punonjësit të policisë së burgjeve E. D.

Nga këqyrja e dokumentacionit rezulton se, punonjësi i rolit bazë E. D. është përfshirë në një konflikt me një koleg në datën 04.06.2018, në regjimin e brendshëm të IEVP Peqin, kur po kryheshin veprime me të burgosurit. E. D. ka fyer dhe tentuar të godasë kolegun për motive të dobëta. Punonjësit që kanë qenë të pranishëm kanë raportuar ngjarjen tek eprori i tyre, Shefi i Policisë K/Komisar B. K. Ky i fundit ka thirrur në zyrë për sqarim punonjësën E. D., i cili sërish ka përdorur fjalë fyese për kolegun e tij dhe kur i është tërhequr vëmendja për fjalorin e përdorur ai ka fyer edhe Shefin e Policisë. Për shkak të sjelljes së punonjësit E. D. të shfaqur në këtë rast si edhe të sjelljes së shfaqur prej tij në raste të tjera, Shefi i Policisë ka propozuar nisjen e procedurës disiplinore. Dokumentet që na janë vënë në dispozicion lidhur me masën disiplinore të dhënë ndaj punonjësit E. D.¹ janë:

¹ Shkresa me Nr. 283 Prot., datë 29.01.2020 e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin dhe shkresa me Nr. 1658/1 Prot., datë 27.02.2020 e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

- Informacion lidhur me ngjarjen e datës 04.06.2018 ku është përfshirë punonjësi i rolit bazë në Regjimin e Brendshëm, Seksioni “A”, E. D. i përpiluar nga specialisti i Grupit të Sigurisë dhe Shoqërimit Komisar A. M.;
- Informacion për ngjarjen, i përpiluar nga punonjësi i rolit bazë të grupit të sigurisë B. Ç.;
- Informacion për ngjarjen, i përpiluar nga specialisti i regjimit të brendshëm Komisar M. Dh.;
- Propozim për largimin nga detyra të p.r.b E. D. të bërë nga Shefi i Policisë K/Komisar B. K. me shkresën Nr.149 Prot., datë 05.06.2018;
- Verifikim i sektorit ligjor dhe sektorit të personelit të dokumentacionit që shërben për procedurën disiplinore të nisur ndaj p.r.b E. D., shkresa Nr. 2379/3 Prot., datë 13.06.2018;
- Deklaratë për njohjen me aktet normative që përcaktojnë rregullat dhe etikën gjatë punës të nënshkruar nga p.r.b E. D., shkresa Nr. 2379/2 Prot., datë 13.06.2018;
- Njoftim për zhvillimin e seancës dëgjimore të nënshkruar nga p.r.b E. D., shkresa Nr. 2379/1 Prot., datë 13.06.2018;
- Procesverbal i komisionit të disiplinës në IEVP Peqin, i mbajtur në datën 12.06.2018, ku punonjësi E. D. njihet me raportimin e bërë ndaj tij për ngjarjen e datës 05.06.2018 dhe shprehet se *“jam dakort me gabimin që kam bërë si me kolegun ashtu edhe me shefin e policisë”*;
- Urdhër i Drejtorit të IEVP Peqin për dhënien e masës disiplinore “largim nga detyra” të p.r.b E. D. të nënshkruar nga ky punonjës, shkresa Nr.2379 Prot., datë 13.06.2018;
- Propozim i Drejtorit të IEVP Peqin për lirim nga detyra të p.r.b E. D. drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me shkresën Nr.275 Prot., datë 13.06.2018;
- Njoftim i p.r.b E. D. për t’u paraqitur pranë Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, shkresa Nr.6129/1 Prot., datë 25.06.2018 e nënshkruar nga punonjësi E. D.;
- Procesverbal Nr.6179/2 Prot., datë 29.06.2018 i Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve i nënshkruar nga p.r.b E. D.;
- Urdhër Nr.6129/3, datë 29.06.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për largimin nga detyra të p.r.b E. D. i pa nënshkruar prej tij;
- Urdhër Nr.2679 Prot., datë 02.07.2018 të Drejtorit të IEVP Peqin për ndërprerjen e marrëdhënies financiare me p.r.b E. D.

Rregullat për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve parashikohen në Ligjin Nr.10032, datë 11.12.2008 *“Për Policinë e Burgjeve”*², ligji në fuqi në kohën kur është marrë masë ndaj p.r.b E. D., dhe në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr.3125/1, datë 04.09.2009 *“Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve”*.

Legjislacioni i lartpërmendur parashikon masat e ndryshme disiplinore që mund të jepen ndaj punonjësve të policisë së burgjeve, autoritetin kompetent për dhënien e çdo mase, të drejtën e punonjësit të policisë për t’u njoftuar për nisjen e procedurës disiplinore, për t’u dëgjuar, për të dhënë variantin e tij të ngjarjes dhe për t’u njohur me shkrim me vendimin e marrë. Ankesa e ish punonjësit të policisë së burgjeve E. D. ka konsistuar pikërisht në mos njohjen me vendimin e marrë ndaj tij.

Në nenin 36 pika 4 të Ligjin Nr.10032, datë 11.12.2008 *“Për Policinë e Burgjeve”* thuhet se: *“vendimi për masën disiplinore duhet t’i komunikohet me shkrim punonjësit të Policisë*

² Nenet 20, 36, 37, 38, 39, 40 të këtij ligji.

së Burgjeve brenda 5 ditëve pune nga marrja e tij, duke e vënë në dijeni njëkohësisht edhe për të drejtën e tij të ankimit të vendimit”. Po ashtu parashikohet se, punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit merret masë disiplinore “*largim nga Policia e Burgjeve*” ka të drejtë të ankohet në Komisionin e Apelit të masave disiplinore në Ministrinë e Drejtësisë (neni 39 i Ligjit Nr.10032, datë 11.12.2008). Ndërsa neni 61 i Urdhrit Nr.3125/1, datë 04.09.2009 të Ministrit të Drejtësisë përcakton se, komunikimi i vendimit bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë ose personi i autorizuar prej autoritetit përgjegjës për dhënien e masës disiplinore. Punonjësit të policisë, të ndëshkuar me masë disiplinore, duhet t’i jepet një kopje origjinale e vendimit për dhënien e masës disiplinore. Gjithashtu, ky vendim duhet të nënshkruhet edhe për marrjen dijeni të tij, nga punonjësi i policisë. Në rast se ai nuk pranon të nënshkruajë për marrjen në dijeni për vendimin për dhënien e masës disiplinore, vendoset shënimi “*refuzon firmën*”. Urdhri Nr.6129/3, datë 29.06.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për largimin nga detyra të p.r.b E. D. nuk mban nënshkrimin e tij si dhe nuk vihet në dijeni mbi mundësinë e ushtrimit të të drejtës së ankimit të vendimit në Komisionin e Apelit në Ministrinë e Drejtësisë. Nga ana jonë iu kërkua IEVP Peqin të na informonte nëse ishte njohur p.r.b E. D. me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për largimin e tij nga detyra. Në përgjigjen³ që kemi marrë thuhet se, ankuesi ka konfirmuar njohjen me Urdhrit Nr.2379 Prot., datë 13.06.2018 të drejtorit të IEV Peqin ku propozohet lirimi i tij nga detyra me motivacionin “*shkelje e rëndë e përsëritur të Kodit të Etikës së Policisë së Burgjeve ndaj eprorëve dhe kolegëve dhe kërkesave të rregullores që normojnë punën në Policinë e Burgjeve*”.

Gjithashtu kemi konstatuar se, shkresa e njoftimit për zhvillimin e seancës dëgjimore e nënshkruar nga p.r.b E. D. mban datën 13.06.2018, ndërsa seanca dëgjimore ishte caktuar të zhvillohej në datën 12.06.2018, pra një ditë para njoftimit. Nga ana jonë iu kërkua informacion IEVP Peqin për arsyen e kësaj mospërputhje, por nga ky institucion nuk na është dhënë ndonjë shpjegim. Referuar procesverbalit të mbajtur nga komisioni disiplinor i IEVP Peqin rezulton se seanca dëgjimore është zhvilluar në datën e caktuar, 12.06.2018 dhe punonjësi i policisë E. D. ka marrë pjesë dhe ka dhënë mendimin e tij gjatë saj.

Rezulton pra, se vetëm një pjesë e hapave proceduriale janë të evidentuara dhe se mungon konfirmimi i njoftimit të urdhrit të largimit që është edhe akti përfundimtar i përmbylljes së procedurës disiplinore. Ky akt mund të dërgohet me postë në adresën e njohur të punonjësit dhe në të duhet të garantohet e drejta e ankimit ndaj vendimit.

Në këto rrethana, vlerësojmë se ka pasaktësi në administrimin dhe protokollimin e shkresave gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore ndaj këtij ish punonjësi si dhe mosrespektim të procedurës në përputhje me legjislacionin për dhënien e masës disiplinore ndaj punonjësi të policisë së burgjeve E. D. për sa i përket formës së komunikimit të vendimit dhe vënies në dijeni të mundësisë për t’u ankuar ndaj vendimit.

Theksojmë se e drejta e ankimit nuk mohohet nga ligji edhe nëse nuk shënohet në aktin e largimit nga detyra, por luan rol të rëndësishëm në garantimin efektiv të së drejtës së ankimit nga ana e organeve të administratës shtetërore.

E drejta për një proces të rregullt ligjor sanksionohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, më konkretisht në nenin 42/1 ku thuhet se: “*Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor*”. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ. Në këtë kuptim, ajo është shprehur

³ Shkresa Nr.2963 Prot., datë 26.11.2020.

se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masë administrative, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore. E drejta për t'u dëgjuar, si pjesë e të drejtës së mbrojtjes, garantohet edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij, ose avokatit të zgjedhur. (shih vendimin nr.76, datë 25.04.2002 dhe nr. 29 datë 27.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

REKOMANDOJMË:

- Respektimin e procedurës në përputhje me legjislacionin për dhënien e masës disiplinore ndaj një punonjësi të policisë së burgjeve për sa i përket formës së komunikimit të vendimit dhe vënies në dijeni të mundësisë për t'u ankuar ndaj vendimit.
- Marrjen e masave për administrimin dhe protokollimin e saktë të shkresave gjatë procedurës së dhënies së masave disiplinore ndaj punojësve të policisë së burgjeve.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi